



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

KËSHILLI DREJTUES

Nr. 84 Prot.

Datë 30.07.2020

VENDIM

Nr. 05, datë 30.07.2020

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË AKTIVEVE AFATGJATA
MATERIALE TË AEROPORTIT TË KUKËSIT

Bazuar në nenin 6, gërma “e” e Ligjit Nr. 10233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar, Vendimit nr.4, datë 22.05.2019 “Transferim kapitali të pjesëve navigacionale, të Aeroportit të Kukësit, në pronësi të AAC-së, Albcontrol sha”, shkresës së Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 8700/1, datë 07.11.2019 “Emërim eksperti për vlerësim” dhe “Raportin e Vlerësimit të Aktiveve Afatgjata Materiale të Aeroportit të Kukësit” nr. 81, datë 13.01.2020, me propozim të Drejtorit Ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil, Këshilli Drejtues

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit për Vlerësimin e Aktiveve Afatgjata Materiale Navigacionale të Aeroportit të Kukësit, të kryer nga ekspertët e pavarur.
2. Ngarkohet AAC për përcjelljen e këtij vendimi në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për ndjekjen e procedurave ligjore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Dritan Gjonbalaj

Dritan
Gjonbalaj

Digitally signed by
Dritan Gjonbalaj
Date: 2020.07.30
02:12:21 +02'00'